

Botuesi: Qendra për zhvillimin e komuniteteve – portal KoSëv

Adresa: Kralja Petra I, pn, Mitrovica Veriore

E-mail: kossevportal@gmail.com

Web faqja: www.kossev.info

Autorja: Anđela Milivojević

Ky publikim është përpiluar më mbështetje të Ambasadës të shteteve të bashkuara të Amerikës në Prishtinë. Përmbajtja dhe mendimet të paraqitura në këtë dokument janë përgjegjësi ekskluzive e Qendrës për zhvillimin e komuniteteve dhe në asnjë mënyrë nuk paraqesin qëndrimet e organizatës donatore.

Të gjitha të drejtat të autorit i mbanë Qendra për zhvillimin e komuniteteve. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të publikohet në asnjë formë apo në çfarëdo mënyre tjetër pa lejen paraprake.

Mars 2020

Dialogu i Brukselit në vitin 2019 – viti në cilin dialogu nuk ekzistonte

Më shumë se një vjet dialogu i Beogradit dhe Prishtinës për normalizimin e raporteve në kuadër të negociatave të Brukselit ka ngecur në vend. Prej sa Prishtina në muajin nëntor të vitit 2018 ka vendosur taksat në mallin nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina prej 100% negociatat janë pezulluar në tërësi, e dy kryetarët Aleksandar Vučić dhe Hashim Thaçi janë takuar vetëm njëherë. Përkundër mesazheve të shumta nga BE dhe SHBA që taksat të hiqen në mënyrë që të vazhdohet dialogu, kjo nuk ka ndodhur, e nga Qeveria e re e Kosovës pritet që negociatat t'i lëvizë nga pika e vdekur. Edhe pse dialogu zyrtarisht nuk është përtërirë, si hap i rëndësishëm në normalizimin e raporteve është karakterizuar nënshkrimi i marrëveshjes regionale për zvogëlimin e çmimeve të raomingut në mes të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, ndërsa një hap i ri është bërë me nënshkrimin e letrës lidhur me qëllimet për hapjen e avio linjës Beograd-Prishtinë në janar të vitit 2020, si dhe nënshkrimi i para sa kohe i marrëveshjes për riaktivizimin e hekurudhës në të njëjtin relacion. Mirëpo, ekspertët tregojnë në atë se asnjëra prej marrëveshjeve nuk është produkt i dialogut në Bruksel, zyrtarët e të cilit nuk kanë pasur rol të dukshëm në negociata dhe theksojnë se dialogu edhe më tej është nën pikëpyetje.

Në muajin nëntor të vitit 2018, Qeveria e Kosovës e udhëhequr me kryeministrin e atëhershëm Ramush Haradinaj i ka vënë taksat prej 100% në mallin të importuar nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina për shkak të, siç është thënë atëherë “përpjekjeve agresive të Serbisë për ta delegjitimuar Kosovën”. Dy ditë para vënies së taksave Kosova nuk ka arritur të bëhet anëtare e INTERPOL-it , për shkak të kinse aktivitetit të fuqishëm diplomatik të Serbisë që të parandaloj atë.

Si reaksion në vënien e taksave kryetari i Serbisë Aleksandar Vučić ka porositur se nuk ka bisedimeve të mëtejshme në kuadër të dialogut të Brukselit derisa taksat nuk hiqen. Kjo gjendje deri sot nuk është ndryshuar, e dialogu edhe më tej gjendet në krizë të thellë edhe pse ka kaluar më shumë se një vjet nga takimi i fundit.

Vet dialogun e Brukselit ekspertet shikojnë në dy mënyrë – si dialog teknik i cili duhet ta lehtësoj funksionimin e përditshëm dhe jetën në Kosovë dhe si dialog politik i cili duhet ta jep përgjigjën në pyetje se si në afat gjatë do të bashkëpunojnë Beogradi dhe Prishtina.

Prej vitit 2013 kur ka filluar dialogu, në më shumë se 120 takime janë nënshkruar më shumë se 40 marrëveshje teknike, duke përfshirë edhe revizionet e disa marrëveshjeve. Marrëveshjet më të njohura janë ato për lirinë e lëvizjes të cilat kanë pasur efekte më të dukshme kur lëvizja e qytetarëve nga Kosova nëpër Serbin qendrore është në pyetje, pastaj marrëveshja për Bashkësinë e komunave serbe (BKS), për telekomunikacionet dhe integrimin e policisë dhe gjyqësorit. Megjithatë, për herë të parë nga fillimi i procesit të negociatave dialogu është ndaluar në tërësi, kurse negociatat për zgjedhjeve teknike dhe politike për raportet e Beogradit dhe Prishtinës janë lënë anash.

Edhe pse, formalisht, nuk ka pasur negociata, tema për të cilën është filluar të flitet prej vënies së taksave është gjetja e zgjedhjes të ashtuquajtur të përhershme ose “marrëveshjes gjithëpërfshirëse”, gjë e cila e ka shënuar vitin 2019.

Bashkëpunëtori i lartë i Këshillit të Berlinit për demokratizimin e politikës Bodo Veber [në bisedën për KoSSev](#) në fund të viti 2018, ka tërhequr vërejtjen se skenari më real është ndalesa në negociata deri të ardhja në detyrë të pasardhësit të Federika Mogerini në pjesën e dytë të vitit 2019, që pikërisht edhe ka ndodhur.

Në anën tjetër, diplomatet amerikan, përkundër vënies së taksave, më optimizëm kanë folur për “marrëveshjen përfundimtare juridikisht obliguese”, “marrëveshjen gjithëpërfshirëse”, si për diçka që është e mundur të arrihet shpejt.

Kështu, Filip Kosnet, Ambasador i SHBA në Prishtinë [në intervistë për KoSSev](#) në muajin dhjetor të vitit 2018 ka thënë se kryetari i SHBA Donald Tramp posaçërisht është i interesuar që çështja e Kosovës të zgjidhet.

“Nuk kamë parë se SHBA kanë treguar angazhim të tillë, këtë nivel të energjisë dhe prestigj lidhur me këtë çështje. Dua të them se administrata e Trampit vëzhgon atë që e thërrasim konfliktet të ngrira nëpër botë dhe thotë: “Duhemi t’i lëkundim çështjet. Tash duhet të bëjmë përparim”.

Kosneti ka pritur që në vitin 2019 do të jetë të mundur që të arrihet deri të marrëveshja gjithëpërfshirëse, por ajo nuk ka ndodhur.

“Mendoj që viti 2019 duhet të jetë viti e marrëveshjes gjithëpërfshirëse. Nëse raporti në mes të Serbisë dhe Kosovës nuk përmirësohet, do të behet edhe më keq. Me të vërtetë nuk ekziston opsioni që të mbahet statusi kvo”.

Mesazh i ngjashëm është dëgjuar edhe disa muaj më vonë: “Marrëveshja gjithëpërfshirëse, reciprokisht e dobishme në mes të Serbisë dhe Kosovës është mënyra që të arrihet kjo perspektivë, ku rolin kyç luan përkushtimi në njohje reciproke”, [ka thënë për KoSSev nënsekretari amerikan Dejvid Hejl](#) në mars të vitit 2019.

Tema e marrëveshjes gjithëpërfshirëse gjithnjë e më shpesh hynte në diskurs publik derisa tema konkrete nga marrëveshja e Brukselit, siç është pyetja e Bashkësive të komunave serbe, pothuajse janë të harruara.

Në prill të vitit 2019 në Beograd [është nënshkruar marrëveshja regjionale për zbritjen e çmimeve të raomingut](#) në mes të gjashtë nënshkruesve të Ballkanit Perëndimor, në mesin e të cilëve ka qenë edhe Kosova, gjë e cila është interpretuar si hap pozitiv në normalizimin e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës edhe pse marrëveshja nuk ishte pjesë e dialogut por pjesë e iniciativës regjionale.

Në situatën kur negociata pothuajse kanë vdekur, me iniciativën e Gjermanisë, në prill të viti 2019, për herë të parë janë takuar kryetarët Vučić dhe Thaçi në samitin e Berlinit, por takimi nuk ishte i suksesshëm.

“Kemi pasur vetëm një kusht për vazhdimin e dialogut, që taksat të tërhiqen, e Shqiptarët kanë thënë se duhemi të njohim Kosovën”, ka thënë kryetari i Serbisë Aleksandar Vučić, pas samitit të dedikuar Ballkanit Perëndimor.

Në atë moment analistët kanë treguar se dialogu gjashtë vjet prej fillimit të negociatave të Brukselit ka ra në krizë më të thellë, se tema e negociatave është zëvendësuar me tema siç është ndarja etnike, e që liderët politik nga Beogradi dhe Prishtina [bëjnë të gjitha që mos të vihet deri të implementimin](#) e marrëveshjes së Brukselit.

Deri në verën e vitit 2019, përveç komenteve të ashpra të herëpashershme në media, BE nuk ka arritur përsëri ta kthej në tryezë palet në dialog.

Kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Ramush Haradinaj, në fillim të muajit korrik [në intervistë për KoSSev](#) ka thënë se nuk do të ketë kthim në tryezën e negociatave derisa nuk vendosët korniza e qartë e dialogut rezultati i të cilit do të jetë pranimi i pavarësisë së Kosovës dhe se taksat do të mbesin në fuqi për sa kohë që ai është kryeministër. Dy javë pas intervistës, Haradinaj ka dhënë dorëheqjen për shkak të thirrjes për marrje në pyetje në Hag në cilësinë e të dyshuarit. Atëherë ka qenë e qartë se ripërtrirje të dialogut nuk do të ketë derisa nuk formohet Qeveria e re e Kosovës.

Interesimi i SHBA që çështja e dialogut të fillon nga pika e vdekur është parë vetëm në pjesën e dytë të vitit 2019 kur [në fund të muajit gusht Metju Palmer është emëruar](#) për të dërguarin special për Ballkan, për ta emëruar kryetari Tramp në muajin tetor edhe një diplomat, ambasadorin e SHBA në Gjermani Richard Grenel, për të dërguarin special për negociata në mes të Beogradit dhe Prishtinës.

Rezultate e para konkrete të këtyre emërimeve janë parë në muajin janar të vitit 2020, kur papritmas është nënshkruar letra për qëllimet për vendosjen e fluturimit Beograd-Prishtinë në ambasadën amerikane në Berlin, në prani të ambasadorit të SHBA dhe të dërguarit special të kryetarit amerikan për dialog në mes të Beogradit dhe Prishtinës Richard Grenel.

Diçka më pak se një muaj pas kësaj marrëveshje, e pasi që edhe formalisht është themeluar Qeveria e re e Kosovës në krye e së cilës ka ardhur Albin Kurti, edhe një marrëveshje e cila do të lehtësonte trafikun në mes të Beogradit dhe Prishtinës është nënshkruar me ndërmjetësimin e diplomacisë amerikane.

Përkundër lajmërimeve të Kurtit se ai do të merr udhëheqjen e negociatave, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së re në mes të shkurtit të vitit 2020 të pranishëm kanë qenë negociatorët e vjetër, kryetarët Vučić dhe Thaçi. Këtë herë në Minhen, janë nënshkruar marrëveshjet të cilët duhen të sjellin deri të ripërtrirja e lidhjes hekurudhore Prishtinë-Nish dhe ndërtimi i autostradës Beograd-Prishtinë.

Edhe pse ai ishte njëri prej takimeve të para në mes të dy kryetarëve gati pas një viti të bllokadës së dialogut, analistët theksojnë se marrëveshjet e arritura nuk janë produkt i bisedimeve në Bruksel, duhet pasur parasysh se negociatat edhe më tej janë në ngecje dhe se nga BE pritët që përsëri ta sjellë dy anët pranë tryezës së negociatave. Theksohet se ekipet për dialog në të dy anët praktikisht janë të shpërbëra në periudhën paraprake gjë e cila krijon problem të madh në implementimin e marrëveshjeve të arritura në teren, në monitorim dhe në zgjidhjen e problemeve praktike.

Si njëra prej mënyrave që dialogu i Brukselit të përtërihet është shfaqur ideja që BE të emëron të dërguarin special për Ballkan i cili do të vazhdonte të udhëheqë negociatat në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Përfaqësuesi i lartë i Bashkësisë Evropiane për politikën e jashtme dhe sigurisë, Josep Borell, në muajin mars ka lajmëruar kryeministrin Kurti se [ka propozuar Miroslav Lajcak](#), ministrin e punëve të jashtme të Republikës së Sllovakisë, për përfaqësuesin special e BE për dialog Beograd-Prishtinë dhe për Ballkanin Perëndimor.

Si pengesë kryesore për përtërirjen e dialogut kanë mbetur taksat në mallin nga Serbia dhe BdhH.

Kryeministri Kurti kah fundi i muajit shkurt ka paralajmëruar se taksat në import të lëndës së parë nga Serbia dhe BdhH, [mund të hiqen prej datës 15 mars](#), e nga 1 prilli edhe në të gjitha produktet, nëse Serbia ndërprente kampanjën e tërheqjeve të njohjeve të Kosovës. Mirëpo, heqja e taksave në lëndë të parë me 15 mars, siç ka sqaruar Kurti, nuk ndodhur për shkak të mungesës të qëndrimit të përbashkët me partnerin e koalicionit, LDK-ën. Megjithatë, në seancën e mbajtur në largësi, me datën 20 mars, qeveria e Kurtit ka miratuar propozimin e tij për heqjen e taksave në lëndën e parë dhe atë pas rrënimit drastik të raporteve në mes të partnerëve të koalicionit, për shkak të mospajtimeve të shumta – nevojës të dëgjohet kërkesa e SHBA-ës dhe taksat të të hiqen në tërësi dhe menjëherë dhe qëndrimit për nevojën për vënien e gjendjes të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë të virusit korona. Sipas vendimit të ri të qeverisë të Kosovës i cila ka hy në fuqi me datën 21 mars, taksat në tërësi do të hiqen me 1 prill, nën kushtet të paraqitura më herët. Mirëpo, për shkak të mos stabilitetit në koalicionin qeveritar, me ç’ rast LDK ka fituar votat për votimin e mosbesimit qeverisë të partnerit të vet të koalicionit, pikëpyetje është se qeveria e re e Kosovës a do të qëndroj deri të zbatimi i këtij vendimi.

Ideja për demarkacion pa mbështetje dhe plan të qartë

Ideja e demarkacionit, korrektimit të kufijve apo shkëmbimi i territoreve është bërë aktuale gjatë verës të vitit 2019.

Analistët në Serbi dhe në Kosovë temën e demarkacionit e kanë interpretuar si goditje e cila e ka vrarë dialogun e Brukselit, e jo që ka kontribuar në zgjidhjen e tij përfundimtare:

“Ideja për ndarjen nuk është vazhdimi apo përfundimi logjik i marrëveshjes së Brukselit por xhelati i tij. Marrëveshja e Brukselit është koncepti i braktisur, ndërsa dëmi i cili i është shkaktuar këtij procesit është i pa kompensuar”, [ka thënë për KoSsev Miodrag Marinković](#), analisti politik nga Mitrovica Veriore.

Çka saktësisht nënkuptohet në ndarje, demarkacion, korrigjim i kufijve, asnjëherë nuk është publikuar zyrtarisht, e as që është marrë qëndrimi i qartë se kjo është propozim zyrtar i të dy anëve në dialog.

Në anën serbe, kur është folur për caktimin e kufijve, është menduar në ndarjen e Kosovës me të cilën Veriu i Kosovës, ku gjenden katër komuna serbe do të takonte Serbisë, ndërsa në Kosovë për caktimin e kufijve është folur si për bashkimin e “Rrafshit të Preshevës”, me bashkimin eventual të një pjese të Veriut Serbisë.

[Opinionit e ekspertëve ka genë i ndarë](#) rreth qëndrimit ndaj idesë së ndarjes. Në një anë kanë ekzistuar mendimet të cilët i kundërshtohen kësaj ideje sepse konsiderojnë se ai skenar do të qonte deri në atë që

bashkësia serbe në Kosovë të dobësohet dhe të humbë ato të drejta kushtetuese të cilat momentalisht i janë garantuar, gjë e cila për pasojë do të ketë shpërngulën e përsheptuar mbi 70 000 serbëve në anën jugore prej lumit Ibër. Edhe pse nuk do të ketë shpërngulje të organizuar, Serbët të cilët do të mbesin në Kosovë, pas ndarjesdo të jenë nën presion jo vetëm të integrohem, por të asimilohen, ka theksuar një pjesë e ekspertëve.

Në anën tjetër, ithtarët e ndarjes kanë theksuar se bashkësia serbe duhet të ketë të drejtë të deklarohet ku dëshiron të jetoj, ashtu siç kjo e drejta është pranuar popullsisë shqiptare, dhe se ndarja do të parandalonte shkuarjen masive të Serbëve nga Kosova e cila viteve të fundit është dominuese.

Analistet nga Kosova kanë theksuar se për Shqiptarët në Kosovë ndarja pothuajse është e pamundur nëse bëhet fjalë për atë se Kosova do të mbetet pa Mitrovicë në Veriun. Për këtë arsye është cekur se ndryshimi i kufijve është zgjedhje shumë e rrezikshme dhe e keqe, por edhe zgjedhja e tillë është më e mirë se kurrfarë zgjedhje.

Në deklaratat publike e presidentit Vučić, ministrit të punëve të jashtme Ivica Dačić dhe ministrit e mbrojtës Aleksandar Vulin, [mund të identifikohet avokimi për këtë ide](#) si njëfarë lloj kompensimi Serbisë për Kosovën e humbur. Edhe derisa në koalicionin qeveritar në Serbi, ideja e ndarjes nuk ka sjellë përçarje, përkundrazi, në skenën politike kosovare, ka ardhur deri të përçarja e dukshme pikërisht lidhur me çështjen e ndarjes në mes të kryetarit dhe kryeministrit. Kryeministri Haradinaj në disa raste ka cekur se me iniciativën e tij me vënien e taksave në mallin nga Serbia [është parandaluar ideja e ndarjes së Kosovës](#) pas së cilës, siç pohonte, qëndron treshja [Vučić, Thaçi dhe kryeministri i Shqipërisë Edi Rama](#).

“Serbia ka kërkuar 950 kilometra. Konkretisht. Tema e ndarjes më nuk është në tryezë, çështjet janë zhvilluar më tutje. Vučić edhe më tej shfrytëzon ndarjen. Ata e bëjnë punën e tyre”, [ka thënë Haradinaj](#) në shtator të vitit 2019.

Edhe kryeministri i ri i Kosovës albin Kurti, i kundërvihet kësaj ideje. Menjëherë pas emërimit të tij në muajin shkurt të këtij viti qartë ka porositur se çfarëdo bisedë për ndarjen e territorit më nuk është temë për biseda dhe negociata. Të njëjtën gjë e ka porositur edhe pasi që ka fituar zgjedhje.

“Nuk ka dialog për kufijtë. Këto janë qëndrimet e mija. Vučić edhe njëherë duhet të kuptoj se çka nënkupton ardhja e Vetëvendosjes në pushtet. Dhe besoj se ai atë e din shumë mirë”, [ka thënë Kurti](#) në tetor të vitit 2019.

Dhjetë ditë më vonë kryetari i Serbisë Aleksandar Vučić ka porositur se nuk ka njohje të Kosovës në kufijtë aktuale dhe se ideja e BE ka qenë modeli i marrëveshjes të dy Gjermanive, pa njohje formale nga ana e Beogradit.

„Prishtina duhet ta heq taksat dhe pastaj do të duhej që për të gjitha çështjet, pa parakushte, të bisedojmë. Mirëpo, nëse veç para dialogut të mundshëm thuhet “nuk bisedojmë për territore, nuk bisedojmë për autonominë për Veriun, për çka atëherë duhet ta bisedojmë? Në këto kushte nuk ka negociata”, [ka porositur Vučić](#).

Në opinionin ndërkombëtar ideja për caktimin e kufijve etnik si zgjidhje e vetme e mundshme ka pasur kryesisht jehonë negative nga vet fillimi ku më së shumti është dalluar Gjermania. Mesazhe të ngjashme kanë mundur të dëgjohen edhe gjatë vitit 2019.

„Si të tjerët, as ne nuk mendojmë se ajo është rrugë pozitive përpara, por qartë, do të shohim se si negociata do të zhvillohen në suazat e parametrave të caktuara”, ka thënë [në intervistë për KoSSev në shtator të vitit 2019](#) ambasadori i ri Britanik Nikolas Ebot i pyetur nëse Britania e mbështet idenë e demarkacionit të kufijve. Mesazh të ngjashëm ka dërguar edhe [ambasadori i Rusisë në Serbi Aleksandar Bocan-Harčenko](#) i cili ka thënë se Rusia nuk angazhohet për ndarjen e Kosovës.

Në anën tjetër diplomatët amerikan nuk kanë folur me një qëndrim të prerë përjashtues për idenë e ndarjes apo demarkacionit.

Richard Grenel si dërguarin special analistët e kanë parë si [person i cili do të mbështetë idenë për shkëmbimin e territoreve](#) si mënyrë që çështja e statusit të Kosovës zgjidhet sa më parë dhe si dikend që do të [mund ta bindte Gjermaninë të mbështetë këtë ide](#).

Mbështetje kësaj ideje gjatë vitit 2019 i ka dhënë edhe kryeministri i Austrisë Sebastijan Kurc.

“Qëndrimi jonë është i qartë: mbështesim të gjithë atë për çka pajtohen palët, e kështu edhe korrigjimet e mundshme të kufijve, nëse kjo në fund shpien zgjidhjes gjithëpërfshirëse, e cila do të sillte më tepër stabilitet. Qëllimi duhet të jetë që të gjitha pyetjet të hapura të zgjidhen me marrëveshje në dialog”, [ka shpjeguar Kurc](#).

Mirëpo, [në intervistë për KoSSev](#) në muajin dhjetor të vitit 2019, ambasadori amerikan në Prishtinë, Filip Kosnet, ka porosit se edhe që ideja e ndarjes ndoshta nuk është në tërësi e hedhur, ajo nuk ka mbështetje për t’u realizuar.

“Nëse dëshirojnë të bisedojnë për atë, qëndrimi jonë është se nuk duhet të ndalohen për të biseduar për këtë. Mirëpo, “ndarja” – fjala të cilën e shfrytëzoni është shumë dramatike. Thjesht nuk shoh kurrfarë mbështetje për ndarje...për shkëmbimin e territoreve, shkëmbimin e popullatës, për një ndryshim aq të madh dhe afatgjatë, nuk shoh se për atë ekziston ndonjë mbështetje”.

Çka qytetarët mendojnë për dialog?

Ekspertet theksojnë se marrëveshja e Brukselit nuk ka përmbushur qëllimin e saj themelor – normalizimin e raporteve në mes të Serbëve dhe Shqiptarëve dhe se ngecja e saj në vitin 2019 në mënyrë shtesë ka ndikuar në raportet të shtrënguara në mes të dy popujve.

Raportet në mes të Serbëve dhe Shqiptarëve, sipas vlerësimit të pandarë të shumicës, janë në nivelin më të ulët nga vet fillimi i procesit të negociatave në Bruksel para gjashtë vite.

[Hulumtimet e opinionit publik për vitin 2019](#) të cilat i ka zbatuar Qendra për dialog shoqëror dhe iniciativë regjionale kanë treguar se 62% të qytetarëve të Serbisë nuk janë të njoftuar me detajet e dialogut në Bruksel. Në pyetje se çfarë qëndrimi kanë ndaj dialogut, gati 56% konsiderojnë se negociatat

nuk do t'i kontribuojnë përmirësimit të raporteve në mes të Serbëve dhe Shqiptarëve, 57% nuk pajtohen me idenë që Serbët dhe Shqiptarët kanë të drejta të njëjta sa i përket Kosovës, e njohja e Kosovës si shtet i pavarur për 69% të qytetarëve është tradhti e interesave kombëtare.

E sa qytetarët të Serbisë janë të hapur për idenë që Serbia në njëfarë forme të pranon Kosovën në mënyrë që të vihet deri të zgjidhje përfundimtare shihet në atë se vetëm 36% prej tyre do të mbështesin marrëveshjen me të cilën Serbia pranon Kosovën me shkëmbim për katër komuna veriore, bashkësinë e komunave serbe në jug dhe eksterritorialitet të manastireve të kishës ortodokse Serbe. Pastaj vijon marrëveshja me të cilën Serbia nuk do të njohë Kosovën, por do ta pranonte anëtarësinë e Kosovës në UN në shkëmbim për BKS për të cilin në referendum do të votojnë 32% të qytetarëve. Shkëmbimin e territoreve sipas parimit katër komuna veriore për pjesë e komunave Preshevë dhe Bujanoc do ta pranonte 15% të intervistuarit.

Hulumtimi tregon se asnjëri nga skenarët të ofruara nuk ka mbështetjen e shumicës e qytetarëve të Serbisë.

Në intervistë për KoSSev autori të këtij hulumtimi, Nikola Jović, asistent në Fakultetin e shkencave politike në Universitetin e Beogradit ka thënë se [75% e qytetarëve të Serbisë ka qëndrim negativ ndaj dialogut](#) në mes të Beogradit dhe Prishtinës, sepse e shohin si rrugë për pranimin e pavarësisë së Kosovës.

Në anën tjetër, hulumtimi i qëndrimeve të qytetarëve të Kosovës për dialog, të cilin e ka bërë Qendra kosovare për studime të sigurisë ka treguar se shtatë përçin të qytetarëve të Kosovës e shohin Serbinë si një prej tri top rreziqeve për sigurinë kombëtare të shtetit, ndërsa ndarja e Kosovës për 78% e qytetarëve është rizik i brendshëm për sigurinë kombëtare. Afro 90% e qytetarëve të Kosovës e shohin Serbinë si ndikim i dëmshëm në politikën e jashtme të Kosovës, ndërsa 97% Shqiptarëve e shohin Serbinë si të dëmshme.

Hulumtimi ka treguar se 48,42% e qytetarëve të Kosovës konsideron se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë do të duhet të vazhdohet dhe të arrihet marrëveshja, ndërsa 14,44% e qytetarëve kundërshton vazhdimin e dialogut, e afro 9% e qytetarëve konsideron se dialogu do të duhet të vazhdohet derisa Serbia nuk e pranon Kosovën.

Por, perceptimi i gabuar në mes të dy popujve nuk ka ndikuar në atë se në disa qytete në Kosovë Serbet dhe Shqiptarët bashkëpunojnë në mënyrë për t'i zgjedhur probleme të përbashkëta. Shembulli më i bindshëm i tillë në vitin 2019 kanë qenë [protesta të përbashkëta të qytetarëve të Shtrpcës](#) kundër ndërtimit të mini hidrocentraleve në lumenjtë e malit të Sharrit.

Roli i mediave mund të jetë kyç për suksesin e dialogut

Edhe pse dialogu gjatë vitit 2019 nuk ka ekzistuar ekspertet tregojnë se mediat në Serbi, posaçërisht tabloidët, në masë të konsiderueshme negativisht kanë ndikuar në pajtimin e dy popujve me përdorimin e gjuhës së urrejtjes me rastin e raportimit për Kosovën.

Kështu në ballinat e tabloideve pro qeveritare kanë mundë të shihen titujt: “Shqiptarët po keqtrajtojnë! Tortura e Shqiptarëve! Shqiptarët përsëri i arrestojnë Serbët! Punët abnormale të Shqiptarëve! Shqiptarët po i keqtrajtojnë Serbët – provokojnë konfliktet të gjakosura! Shqiptarët ‘po ua prenë kokat’ Serbëve! Në gënjeshtër janë të shkurtra këmbët e Shqiptarëve!”

Ekspertet theksojnë se në vitet e fundit mediat pro qeveritar në Serbi në mënyrë kyçe ndikojnë në krijimin e narrativit antishqiptar në mes të qytetarëve.

„Në mediat në kontrollin e makinerisë propagande të Vučićit, pandërprerë riprodhohet raporti emotiv ndaj Kosovës. Ai nuk është diskursi emotiv pozitiv, i prezantuar në narrativin Kosova është zemra e Serbisë, por pikërisht është e kundërta, bëhet fjalë për narrativin i cili është krijuar prej urrejtjes dhe mos durimit ndaj Shqiptarëve. Narrativi i krijuar i ri është regresiv, johuman dhe fundamentalisht antishqiptar”, [ka shkruar në analizën për KoSSev](#) Nikola Jović asistent në Fakultetin e shkencave politike në Beograd.

Kjo tendencë e mediave në esencë është në kundërshtim me mesazhet zyrtare të cilat i dërgon kryetari i Serbisë Vučić, i cili në fjalimet të tija publike thekson se doemos duhet të arrihet marrëveshja dhe se duhet të vihet deri të zgjidhje kompromise, thekson ai më tej.

Siç janë, sipas hulumtimit e opinionit publik të Qendrës për dialogun shoqëror dhe iniciativën regjionale mediat pro qeveritar ata që më së shumti ndikojnë në qëndrimet e opinionit publik në Serbi, ekspertet tregojnë se pikërisht mediat mund të jenë kyç për suksesin e negociatave të ardhshme të Beogradit dhe Prishtinës.

Ekspertët konsiderojnë se roli i mediave është kryesorë për ardhmërinë e dialogut sa i përket qytetarëve të Serbisë, sepse raportimi neutral apo raportimi i cili mbështet idenë për arritjen e marrëveshjes me Prishtinën e mediave pro qeveritare në periudhë prej 6 muajve deri në dy vjet do të mund të sillte deri të nënshkrimi i marrëveshjes të cilën shumica e qytetarëve do ta përkrahte.